

VENDIM
Nr. 96, datë 12.2.2025

**PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s “FOCOPS”, NË
DETIN MESDHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin në operacionin e NATO-s “FOCOPS”, pjesë e operacionit “*Sea Guardian*”, në detin Mesdhe, të 1 (një) anijeje të klasit “Iliria”, e kompletuar me efektivë, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni i anijes është kryerja e detyrave të patrullimit, zbulimit detar, dhënies së ndihmës, njohjes së situatës detare, identifikimit, verifikimit, ndalimit të objekteve detare, në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group-2* (SNMG2), në detet Adriatik dhe Jon (deti Mesdhe), në kuadër të operacionit të NATOS-s, “*Sea Guardian*”, në detin Mesdhe.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në mision kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e misionit.

4. Kohëzgjatja në operacionin e NATO-s “FOCOPS”, pjesë e operacionit “*Sea Guardian*”, në detin Mesdhe, është deri më 31.12.2028. Qëndrimi në këtë operacion është deri në 21 (njëzet e një) ditë në vit, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të anijes në këtë operacion.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës dhe anijen në këtë operacion, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqimin;

ç) sigurimin e anijes;

d) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

dh) mbështetjen shëndetësore;

e) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

ë) karburant, lubrifikantë;

f) transportin e personelit për në zonën e operacionit;

g) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së operacionit;

gj) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

h) taksa portuale, shërbime portuale dhe të kalimit nëpër ngushtica;

i) riparimin e nivelit të dytë të anijes pas kthimit nga operacioni;

j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit të anijes që merr pjesë në këtë operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur të operacionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër merr përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku